



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1944 Prot.

Durrës, më 29.07.2026

**VENDIM**

Nr. 119, datë 29.07.2026

**PËR**

**"DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 31, DATË 18.11.2024 TË SENATIT AKADEMIK "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 30, DATË 06.11.2024 PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË NDRYSHIMEVE TË STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME DHE ORGANIKËS ANALITIKE TË UNIVERSITETIT ALEKSANDËR MOISIU Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Udhëzimit Nr.27 datë 29.12.2017 për "Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"; Statutit të UAMD-së, neni 15, Rregullores së UAMD-së; Vendimit të Senatit akademik nr. 31, datë 18.11.2024; Vendimit të Bordit të Administrimit nr.62, datë 19.11.2024, referuar shkresës së Drejtorisë së Administrimit Financiar me nr. 1867/3 prot., datë 27.07.2026; shkresës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit me nr. 1867/4 prot., datë 27.07.2026, si dhe shkresës Nr. 1867/5 prot., datë 28.07.2026 të Administratorit, Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraparak për disa ndryshime dhe shtesa në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, përkatësisht të strukturës administrative në varësi të Administratorit, sipas tabelës bashkëlidhur dhe relacionet shoqëruese.
2. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi**

